РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
ОПШТИНА ЛИПКОВО - KOMUNA E LIKOVËS
Бр. Nr. 08-259/1
07-03- 2023 год. viti
ЛИПКОВО - LIKOVË

Në bazë të nenit 48 të Ligjit për vetadministrim lokal („Gz. zyrtare e RM„ nr. 05/02), nenit 34 të Statutit të Komunës së Likovës („Fl.zyrtare e Komunës së Likovës„ nr. 01/06, 3/15 dhe 1/19) dhe nenit 58, paragrafi 1 të Rregullores të Këshillit të Komunës së Likovës („Fl. zyrtare e Komunës së Likovës„ nr. 07/2022), Kryetari i KKL-së, sjell këtë:

A K T V E N D I M

për konvokimin e seancës së XX (njëzet) të KKL-së e cila do të mbahet më datë 09.03.2023 (e enjte), me fillim në ora 10,00.

Seanca do të mbahet në sallën e KKL-së, në Likovë.

Për këte seancë propozoj këtë:

REND TË DITËS

1. Verifikim i procesverbalit të seancës XIX-të të KKL-së.
2. Propozim-vendim për pjesëmarrje financiare vetanake të Komunës së Likovës gjatë realizimit të projektit: „Rekonstruimi i rrugës lokale, fsh. Nikushtak – fsh. Vishticë, pjesa 1, faza e dytë„ .
3. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 08-787/3 të dt. 25.08.2022.
4. Të ndryshme.

Këshilli i Komunës së Likovës
Kryetar
Zekirja Shaini



Këshilli i Komunës së Likovës

PROCESVERBALI

i seancës së XIX (nëntëmbëdhjetë) të KKL-së i mbajtur më dt.27.02.2023

Likovë,Shkurt 2023

Në seancën e XIX- ta me rradhë e KKL-së, e mbajtur ditën e hënë, me dt.27.02.2023, me fillim në ora 10:00. Seanca u mbajtë në objektin e Komunës së Likovës, në sallën e këshillit. Të pranishëm në seancë ishin 18 këshilltarë dhe mungoi Qëndresa Zendeli Mamuti.

Kryetari i KKL-së Zekirja Shaini, pasi konstatoi se ka kuorum, fillimisht e hapi seancën me fjalë përshëndetëse, ku dhe më pas propozoi që për këtë seancë të punohet me këtë:

REND DITE

1.Verifikimi i procesverbalit të seancës së XVIII-të.

2. Propozim- vendim për verifikimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Komunës së Likovës Bunjamin Rexhepi.

3.Propozim – vendim për dhënien e pëlqimit për raportin financiar për tre mujorshin e katërt të vitit 2022 të NKP„Pisha„ Komuna e Likovës.

4.Propozim – vendim për dhënien e pëlqimit për angazhimin e 18 punëtorve në NKP„Pisha„Komuna e Likovës.

5. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Faik Konica„f.Sllupçan

6. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Anton Zako Çajupi„f.Hotël

7. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„7 Marsi„f.Opajë

8. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Dituria„f.Likovë.

9. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Kultura„f.Mateç.

10. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„5 Tetori„f.Nikushtak.

11. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHMK„Ismet Jashari„f.Likovë.

12. Propozim- aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin drejtues të IPSH„Shtëpia e shëndetit,f.Likovë, Komuna e Likovës.

13.Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.08-1151/8 të dt.30.11.2022.

14.Propozim-vendim për fillimin e procedurës për punimin e projektit urbanistik për grup të kategorisë së destinimit E-infrastrukturë, pjesë e PK10/1, pjesë e PK 2094 KK Likovë- jashtë rn, Komuna e Likovës.

15.Propozim-vendim për përcaktimin e objekteve pa leje ndërtimi nr.18-885 të dt.03.08.2016 për objekt nr.1 i cili është i vendosur në PK nr.1/1,1194/1 KK Orizare.

16.Propozim-vendim për përcaktimin e vendeve për deponim të mbetjeve ndërtimore.

17.Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë

transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Bashkimi Demokratik për Integrim.

18. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Lëvizja „Besa„.

19. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Lidhja Sociale Demokrate e Maqedonisë.

20. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga lista e Abdulla Rexhepi.

21.Shqyrtim i kërkesës të Klubit të karates „Rinia„f.Mateç.

22.Shqyrtimi i kërkesës të Prof.dr.Afrim Osmani për botimin e librit„Kodi penal i RMV-së.

23.Shqyrtim i kërkesës të banorëve të f.Mateç.

24.Shqyrtimi i kërkesës të Bashkësis lokale të f.Llojan.

25. Të ndryshme

Poashtu Kryetari i KKL-së propozoi që edhe tri pika shtesë të jenë pjesë e rendit të ditës të kësaj seance:

26.Propozim-vendim për fillimin e procedurës për punimin e Projektit urbanistik për infrastrukturë.

27.Shqyrtimi i kërkesës së Bekim Alili.

28.Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizmin e aktiviteteve të përbashkëta me qytetarët: vendosja e pllakave të bekatonit në rrugica dhe hapësira tjera publike.

Kryetari i KKL-së pasi lexoi rendin e ditës me pikat shtesë para këshilltarëve prezent, e kaloj në votim rendin e ditës, dhe konstatoj se u kalua rendi i ditës.

1.Verifikimi i procesverbalit të seancës së XVIII-të.

Arben Jahija: Unë kam vërejtje në lidhje me procesverbalin për arsye se nuk po më duket në rregull si procesverbal nga përmbajtja.

Iljasa Abazi: Unë kam vërejtje për arsye se te pika e rendit të ditës së seancës së kaluar në lidhje me shtëpinë e kulturës që patëm diskutim me Kryetarin e komunës , unë propozova që të bëhen dy osetre objekte me dedikim tjetër e pastja të shfrytëzohen për kulturë, a këtu e keni shënuar në procesverbal një objekt. Për atë kam propozuar që në seanca të këshilli të përdoret inçizim.

Premtim Kamberi: Unë nuk po e shoh të arsyeshme që në çdo seancë bisedohet në lidhje me procesverbalin, duhet të shohim pak se nuk është vetëm procesverbali ka edhe pika tjerë për të cilat çdoherë po votoni ose kundër ose të përmbajtur.

Ilajsa Abazi: I nderuar koleg une e kam që atë që e thomë të jetë ashtu mos të shkruhet ndryshe.

Kryetari i KKL-së: Nuk dua që ta luaj rolin e advokatit për të mbrojtur procesverbalistin, por sa i përket i nderuar këshilltar Iljasa , nuk është ndrruar përmbajtja tek ju nga ajo që keni thënë. Poashtu edhe për provcesverbalistin që vërejtjet e pararshtruara nga këshilltarët të përmirësohen.
Bastri Rexhepi: Për atë edhe unë kam thënë që zgjidhje më e mirë është që seancat të bëhen me inçizim ose drejtpërdrejt.
Nestrine Abazi: Unë kam një vërejtje a ka mundësi te pika e rendit të ditës të ndryshme të diksutojm tani për arsye se po kemi pyetje për Kryetarin e Komunës.
Kryetari i KKL-së: E nderuar në bazë të rregullores pikat e rendit të ditës do të diskutohen siç janë në rradhë, ndërsa sa i përket prezencës së Kryetarit nuk e ka obligim që të jetë prezent gjatë gjithë seancës së këshillit.
Kryetari i Komunës: Sa i përket pyetje që keni si këshilltar drejtuar tek unë edhe nëse nuk jam prezent unë në seancë për arsye se të axhendës që mundem ta kemë janë të obliguar shërbimet e administratës që me shkrim të ju përgjigjen pyetjeve që i keni drejtuar tek unë dhe në seancës e ardhëshme të keni përgjigjen.

Kjo pikë kaloj në votim dhe me 12 „për„ 4 „kundër„ dhe 1 „përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

2. Propozim- vendim për verifikimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Komunës së Likovës Bunjamin Rexhepi.
Kryetari i KKL-së: Të gjithë e dijmë se këshilltari nga rradhët e BDI-së z.Suhejb Emini dha dorëheqje nga pozita e këshilltari, dhe në bazë të renditjes së listës për këshilltarë në rradhë vjen Bunjamin Rexhepi dhe prej sot pjesë e Këshillit të Komunës së Likovës është z.Bunjamin Rexhepi i dëshirojë mirëseardhje në këshill komunal dhe punë të mbarë.
Kjo pikë u vendos në votim dhe të gjithë votuan „për„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

3.Propozim – vendim për dhënien e pëlqimit për raportin financiar për tre mujorshin e katërt të vitit 2022 të NKP„Pisha„ Komuna e Likovës.
Drjetoresha e ndërmarrjes: Para jush e keni edhe materialin e raportit financiat për tre mujorshin e fundit për vitin 2022 të ndërmarrjes , nlse keni diçka pyetje urdhëroni.
Besim Alija: Duke shqyrtuar raportin e katërt po shohë se ka të hyra nga persona fizik, por a ka përmirësime.
Drejtoresha e ndërmarrjes: Po ka përmirësime në krahasim me vitet e tjera.
Bastri Rexhepi:Si është gjendja me pagesat e punëtorëve që bëjnë grumbullimin e mbeturinave nëpër teren.
Drejtoresha: Si infromacion në lidhje me pagesat e punëtorëve të grumbullimin e mbeturinave të gjithë pagesat janë të kryera me rregull.

Kjo pikë u vendos në votim dhe me 16„për„ dhe 2 „përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

4.Propozim – vendim për dhënien e pëlqimit për angazhimin e 18 punëtorve në NKP„Pisha„Komuna e Likovës.
Iljasa Abazi: Së pari i uroj mirë se ardhje këshilltarit Bunjamin Rexhepi dhe i uroj që dë to kemi bashkëpunim të ndërsjelltë për arsye se njihemi shumë kohë më parë.
Deshta të pyes drejtoreshën a bëhet fjalë për persona të angazhuar apo tani do të angazhoehn.
Drejtoresha: Po të gjithë janë të angazhuar dhe kryejnë punë ashtu siç e kanë për obligim.

Abdulla Rexhepi:Të gjithë këto punëtorë për të u angazhuar në punë a ka staf të kompletuar ndërmarrja tani për zhvillim të veprimtarisë.
Arben Jahija:Tek sanitar këtoi punëtor a janë të angazhuar.
Kryetari i Komunës: Në lidhje me punëtorët të cilët janë të angazhuar te ujësjellësi këto realisht tani nuk kanë punë në teren mirëpo duhet të jenë në rrjedha dhe të njoftuar me punët që bëhen te filter stacioni i uji të pijëshëm, por kur të bëjhet në funskioni rrjeti për ujë të pijëshëm atëherë do të themelojm ndërmarrje të re vetëm për ujësjellës.
Iljasa Abazi: Që atëherë është dashur të thuhet që do të themelohet pas 1 viti ndërmarrje e re dhe ne atëherë nuk do të kishim votuar „për„.

Kjo pikë kaloj në votim me 14„për„ dhe 4 „përmbajtur„ , konstatoj se kjo pikë kaloj.

5. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Faik Konica„f.Sllupçan
Abdulla Rexhepi: Unë propozj Llokman Shabani.
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 18„për„ dhe 1 „përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

6. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Anton Zako Çajupi„f.Hotël
Kryetari i KKL-së: Unë propozoj Fatmir Mustafa.
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 17 „për„ dhe 2 „përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

7. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„7 Marsi„f.Opajë
Gzime Saqipi: Unë prpozoj Faredin Osmani.
Kjo pikë kaloj në votim dhe të gjithë votuan „për„.

8. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Dituria„f.Likovë.
Besim Alija: Unë propozoj Valon Mustafa.
Kjo pikë kaloj në votim dhe të gjithë votuan „për„

9. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„Kultura„f.Mateç.
Jahi Jahiji: Unë propozoj Llokman Jasharin.
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 18„për„ dhe 1„përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

10. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHFK„5 Tetori„f.Nikushtak.
Rexhep Zendeli: Unë propozoj Safet Osmani.
Kjo pike kaloj në votim dhe me 18„për„ dhe 1 „përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

11. Propozim – aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin e shkollës të SHMK,,Ismet Jashari,,f.Likovë
Besim Alija: Unë propozoj Nuhi Ajdini
Haxhere Alili Amidi: Osman Zendeli
Nevzad Asipi: Hamdi Sherifi
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 17,,për,, dhe 3 ,,përmbajtur,, konstatoj se kjo pikë kaloj.
12. Propozim- aktvendim për emërimin e një anëtari në këshillin drejtues të IPSH,,Shtëpia e shëndetit,f.Likovë, Komuna e Likovës.
Jahi Jahiji: Unë propozoj Urim Selmani
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 13,,për dhe 5 ,,përmbajtur,, konstatoj se kjo pikë kaloj.

13.Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.08-1151/8 të dt.30.11.2022.
Kjo pikë kaloj në votim dhe të gjithë votuan ,,për,, konstatoj se kjo pikë kaloj.

14.Propozim-vendim për fillimin e procedurës për punimin e projektit urbanistik për grup të kategorisë së destinimit E-infrastrukturë, pjesë e PK10/1, pjesë e PK 2094 KK Likovë-jashtë rn, Komuna e Likovës.
Dije Arifi: Ka të bëjë për Restorant Panorama për vendosjen e trafo shtylla.
Kjo pikë kaloj në votim dhe të gjithë votuan ,,për,,.

15.Propozim-vendim për përcaktimin e objekteve pa leje ndërtimi nr.18-885 të dt.03.08.2016 për objekt nr.1 i cili është i vendosur në PK nr.1/1,1194/1 KK Orizare.
Dije Arifi: E ka ndërtuar objektin ka bërë kërkesë bëhet fjalë për Mendu Nuhiji
Kjo pikë kaëloj në votim dhe të gjithë votuan ,,për,,

16.Propozim-vendim për përcaktimin e vendeve për deponim të mbetjeve ndërtimore.
Gazmend Bakiji: Bëhet fjalë caktimin e vendeve për deponin për hudhjen e mbetjeve ndërtimore.
Kryetari i KKL-së: Duhet të ceket se këto mbeturina a janë Komunës së Likovës a edhe prej komunave tjera.Ju kisha lutur që prej prej komunave tjera mos të i sjellin deponitë.
Abdulla Rexhepi: Unë jam kundër vendit ku është caktuar në f.Sllupçan.
Haxhere Alili Amidi: Po i shohë vendet që janë caktu a ka mundësi wë në f.Nikushtak mos të ekzistojë se e kemi një deponi ne.
Gazmend Bakiji: Bëhet fjalë për të njëjtën deponi që është.
Arben Jahija:E kam një pyetje për f.Orizare është deponi prej moti pasi thatë që do të bëjmë takim me firmat ndërtimore ndërtuese. Duhet të keni parasysh se nëse firmat punojnë në Kumanovë mos të vijnë të hedhin mbeturinat në f.Orizare.
Kryetari i Komunës: Deri tani ka shkuar ashtu siç është gjendja mirpo tani do të mbajmë një takim me firmat ndërtimore që të japim një vërejtje e që për të ardhmen do të ketë edhe sanksione.
Iljasa Abazi: A të që e ceket se prej 11 fshatrave fushor i keni caktuar 6 vende për hedhjen e mbeturinave, pse nuk ka secili fshat deponin e vetë, për arsye se banorët e f.Sllupçan kanë ankesa për arsye se edhe mbeturinat ndërtimore hudhen edhe nga f.Opajë.
Bastri Rexhepi: Pse prap në Nikushtak të ketë deponi për mbeturina ndërtimore, pse nuk caktohet në f.Vishticë ose f.Ropalcë.

Kryetari i Komunës:Këtë breng që ka këshilltari Bastria por në bazë të inspektoriatit për ambient jetësor që materialet të hudhen te deponia për mbulimin e mbeturinave që janë aty të hudhura.

Kjo pikë kaloj në votim dhe me 14„për„ dhe 4 „përmbajtur„ kjo pikë kaloj.

17.Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Bashkimi Demokratik për Integrim.

18. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Lëvizja „Besa„.

19. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga Lidhja Sociale Demokrate e Maqedonisë.

20. Shqyrtim i raportit të përgjithshëm financiar me specifikim të shpenzimeve për të ardhurat dhe të dalurat në llogarinë transakcionale nga dita e hapjes së llogarisë transakcionale deri në mbylljen e llogarisë transakcionale për zgjedhjet lokale për vitin 2021 nga lista e Abdulla Rexhepi.

Pronlongohet për seancë tjetër.

21.Shqyrtim i kërkesës të Klubit të karates „Rinia„f.Mateç.
Kjo pikë kaloj në votim dhe të gjithë votuna „për„ me shumë prej 20.000 denarë.
22.Shqyrtimi i kërkesës të Prof.dr.Afrim Osmani për botimin e librit„Kodi penal i RMV-së.
Kjo pikë kaloj në votim dhe me 18„për„dhe 1 përmbajtur „ konstatoj se kjo pikë kaloj me vlerë prej 10.000 denarë.

23.Shqyrtim i kërkesës të banorëve të f.Mateç.
Kjo pikë kaloj në votim me propozim për përgatitjen e dokumentacionit teknik ku me 14„për„ dhe 3,përmbajtur„ konstaoj se kjo pikë kaloj.

24.Shqyrtimi i kërkesës të Bashkësis lokale të f.Llojan.
Premtim Kamberi:Është kërkesë e bashkësis lokale që të mbushen pankiant për arsye se gjerësia e rrugës po e bënë problem qarkullimin e automjeteve.
Kryetari i Komunës: Është e patjetërsueshme mbushja e pankinave me rërë, poashtu është mirë që të precizohet edhe zgjerimi së paku 70 cm.
Kjo pikë u vendos në votim dhe me 15,për„ dhe 2„përmbajtur„ konstatoj se kjo pikë kaloj.

26.Propozim-vendim për fillimin e procedurës për punimin e Projektit urbanistik për infrastrukturë.

Dije Arifi: Bëhet fjalë për ujësjellësin në f.Hotël.

Kjo pikë u vendos në votim dhe të gjithë votuan „për„

27.Shqyrtimi i kërkesës së Bekim Alili.

Kjo pikë u vendos në votim dhe të gjithë votuan „për„ me i ndihmuar me mjete 15.000 deanrë.

28.Propozim- vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizmin e aktiviteteve të përbashkëta me qytetarët: vendosja e pllakave të bekatonit në rrugica dhe hapësira tjera publike.

Urim Selmani: Bëhet fjalë për programin e njëjtë që e keni votuan disa seanca më parë, por ka ndryshim vetëm te neni 13.

Abdulla Rexhepi: Çka e llogaritni rrugicë dhe hapësir publike.

Urim Selmani: Hapësirë publike llogariten vendet ku janë pjesë e përbashkët e fshatit si psh Sheshi Beqir Sadiku.

Kjo pikë u vendos në votim dhe të gjithë votuan „për„.

25. Të ndryshme

Abdulla Rexhepi: Në lidhje me kanalizimin fekal të një pjese të një lagjjeje në f.Sllupçan. dhe bekatonizimi kur do të fillon në f.Sllupçan

Kryetari i Komunës: Ashtu si u patmi dakorduar mirëpo deri sa të kryhen çështjet administrative me geometrit edhe pastaj dalin në teren. Për bekatonizimin jemi në procedurë të prokurimit publik.

Iljasa Abazi: Ka tre pjesë që nuk janë të unë kanalizimin fekal, si pjesa ka shkolla për ka Mësuesi Tasim ,te mësuesi Atip Demiri lartë, poashtu është kërkesë e banorëve që të vendosin polic të shtrirë në rrugën prej te Xhamia lartë në drejtim për nga shkolla.

Poashtu unë propozova në seancën kur u votua programi për bursa që të i stimulojm 4 nxënës prej shkollës së mesme për të studiuar në drejtime deficitare si për shembul Hidroinxhener.

Kryetari i Komunës: Për kanalizimin pjesa ka shkolla nëse nuk e presim deri sa të bëhet projekti atëherë mundemi që bashkëriht të bëjmë.

Te msësuesi Atip ata nuk dojnë që të bëjmë bashkërisht por kërkojn që ne si komunë të bëjmë të gjithë punën dhe materialin.

Sa i përket stimulimit të nxënësve për të studiuar Hidroinxheneri kemi dy të diplomuar, por edhe nuk kan interes për të shkuar në kësi drejtime.

Nestrine Abazi: Nuk është kompetencë e komunës por linja që është për Shkup ka ankesa prej studentëve që çmimion e biletës e ka të lartë. Me mundësi që me komuniku që së paku të i ketë parasysh studentët.

Bastri Rexhepi: Kur do të nisin punime e ujësjellësit në f.Nikushtak.

Kryetari i Komunës: Bazë të ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor ato tano firma kontraktuese janë duke i bërë matjet gjeodezike dhe fillojn me punë.

Kryetari i KKL-së pasi nuk pati pyetje të tjera i mbylli punimet për këtë senacë në ora 13:00.

Procesmbajtës: Osman Zendeli

Kryetar i KKL-së
Zekirja Shaini

Në bazë të nenit 36 të Ligjit për vetqeverisje lokale („Gz. zyrtare e RM-së„ nr. 05/2002), nenit 33 paragrafi 2 të Ligjit për buxhet („Gz. zyrtare e RM-së„ nr. 64/2005, 04/2008, ... , 192/2015 dhe 167/2016) dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Likovës („Fl. zyrtare e Komunës së Likovës„ nr. 01/2006), Këshilli i Komunës së Likovës, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2023, solli:

P R O P O Z I M - V E N D I M

për pjesëmarrje finanaciare vetanake të Komunës së Likovës gjatë realizimit të projektit: „ Krijimi i kushteve për zhvillim rural, zhvillim të turizmit dhe zhvillim të bujqësisë në rajonin planor Verilindor - Aktiviteti, Rekonstruimi i rrugës lokale, f. Nikushtakt – f. Vishticë, pjesa 1 faza e II-të„

Neni 1

Këshilli i Komunës së Likovës sjell Vendim për pjesëmarrje financiare vetanake të Komunës së Likovës gjatë realizimit të projektit: „ Krijimi i kushteve për zhvillim rural, zhvillim të turizmit dhe zhvillim të bujqësisë në rajonin planor Verilindor - Aktiviteti, Rekonstruimi i rrugës lokale, f. Nikushtak – f. Vishticë, pjesa 1-rë faza e II-të „ , i punuar nga shtëpija projektuese e licencuar „Studio Kubika„ Kumanovë, për të cilin project, egziston dokumentacion teknik i kompletuar d.m.th me revizion, elaborate të nevojshme, leje ndërtimi e tjerë .

Neni 2

Me këtë Vendim, Komuna e Likovës, vërteton se nga buxheti i saj, më saktësisht ate të vitit 2023 ose të vitit 2024, do të marrë pjesë me mjete financiare vetanake në shumë prej 2.760.632,oo denarëve, prej gjithësejt 13.715.632,oo denarëve me TVSH, e cila vlerë është përcaktuar në përputhje me Projektin e lartëpërmendur.

Neni 3

Me vlerën e theksuar në nenin 2 (13.715.632,oo denarë me TVSH), sipas projektit themelor të lartëpërmendur, parashihet që të përfundojn punimet e rrugës lokale në fjalë, edhe ate: Rekonstruimi i rrugës lokale, f. Nikushtak – f. Vishticë, pjesa 1, Faza e II-të, me stacionazhë 0+780.00 – 2+408.00, në gjatësi prej 1630 m, ku duhet përmendur se mjetet e tjera të nevojshme në shumë prej 10.947.000,oo denarëve janë të siguruara nga Ministria për Vetëqeversije lokale – Byroja për zhvillim rajonal, në të cilin organ në emër të Komunës së Likovës, ka aplikuar Qendra për zhvillim rajonal planor veri – lindor, ndërsa shuma e tjetër në vlerë prej 2.768.632,oo denarëve, na mbetet neve si komunë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në „Fl. zyrtare të Komunës së Likovës„.

Këshilli i Komunës së Likovës
Kryetar
Zekirja Shaini

Врз основа на член 22 став 1 точка 4, член 64 став 1 од Законот за локалната самоуправа („Службен весник на Република Македонија“ број 5/02), како и член 40 став 1 точка 43, од Статутот на Општина Липково („Службен гласник на Општина Липково“ бр.01/06), Советот на Општина Липково на XX-та седница одржана на 09.03.2023 година, ја донесе следната:

ПРЕДЛОГ О Д Л У К А
за поништување на одлуката бр. 08-787/3 од 25.08.2022 година

Член 1

Со оваа Одлука се поништува Одлуката на советот на Општина Липково бр. 08-787/3 од 25.08.2022 година.

Член 2

Градоначалникот и Директорот на ЈКП ПИША, се должни да го раскинат Договорот под бр. 03-906/2 од 19.09.2022 година, односно под број на ЈКП ПИША-Липково, 03-122/1 од 19.09.2022 година).

Член 3

Ова Одлука стапува во сила со денот на донесување а ќе се објави и на „Службен гласник на Општина Липково“.

Bazuar në nenin 22 paragrafi 1 pika 4, nenin 64 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 5/02), si dhe neni 40 paragrafi 1 pika 43 Statutit të Komunës së Likovës (“Gazeta Zyrtare e Komunës së Likovës Nr. 01/06) Këshilli i Komunës së Likovës në seancën e XX-të të mbajtur më 09.03.2023, sjell:

PROPOZIM VENDIM
për shfuqizimin e vendimit nr. 08-787/3 të datës 25.08.2022

Neni 1

Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i Këshillit të Komunës së Likovës nr. 08-787/3 të datës 25.08.2022.

Neni 2

Kryetari i Komunës dhe Drejtori i NKP PISHA Likovë, obligohen ta ndërpresin Kontratën me nr. 03-906/2 datë 19.09.2022, përkatsishtë nën numrin e NPK PISHA-Likovë 03-122/1 datë 19.09.2022).

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e sjelljes, dhe do të publikohet në “Fletën Zyrtare të Komunës së Likovës”.

Совет на Општина Липково
Këshilli i Komunës së Likovës
Претседател/Kryetar
Zekirja Shaini